

BIBLIOTEKA
SHTETIT

854-2

8 52

Thanas
Dino

BURRAT E LIRISE



dramë

814-2

852.

Thanas Dino

**BURRAT
E LIRISË**

dramë



08261

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

874-2-202-100
515
Thomas Dino

BURRAT
E LIRISË

dramë

Dino, Th.

Burrat e Lirisë. Dramë. T.,
«Naim Frashëri», 1979.

...f.

B-ka të mëdha dhe

B-ka të vogla: 891.983-2

D 52

SHËRËPJA BOTËSE - NAIM FRASHËRI

V E T Ë T :

ÇERCIZ TOPULLI
MIHAL GRAMENO

GODOJA

SIRATI

MAJKOJA

PLAKU GURO

KAPO — kryetar i komitetit kombëtar

ÇARÇAN MAZJA — bari

OSO VRANJA — malësor 100 e ca vjeç

BEGË LESKOJA

SHAHIN MAZJA

SITKI ÇOBOJA

NUSJA

I ARDHURI NGA JANINA

PREFEKTI I GJIROKASTRËS

MITROPOLITI GREK

BIMBASHI

MUHEDIN BEJ KOKO

ALEM LIBOHOVA

Një rapsod, anëtarë të komitetit kombëtar, luftëtarë popullorë, shitës dhe blerës, një tellall, lajmës, roje, dy vrasës të paguar, katër gra, patrullë turke, një myfti, xhandarë, suitë e bimbashit, ushtri turke, një i dërguar turk, komandanti i asqerëve, etj.

KENGE EPIKE

Ç'u ngre Shqipëria prapë,
me Stamboll vuri inatë,
me Stamboll vuri inatë,
e zu luftën me sulltanë;
zuri luftë me sulltanë,
ç'i punon dyfek' i larë,
prapë ç'u ngre Shqipëria,
Çercizi me djemt' e tia.

KENGE ERKE S K E N A I

Fillimi i shekullit, Breguni Himarës

Citim nga himni patriotik «Për mëmëdhenë». Rapsodi thotë këngën e parë tëpike. Dël Perdja. Dekorori jep idenë e bregut për edhe të thellësisë së vendit, maleve të Labërisë! Afroket një varkë. Zbresin dhe shkelin tokën Çerçiz Topulli dhe Mihal Grameno, pas tyre tre djemtë e çetës: Gëzoja, S'irati dhe Majkoja, pasi kanë lidhur varkën dhe kanë hedhur mbi të lopatat.

ÇERÇIZI — (Me të shkelur bregun.) Gjunjzohu, Mihal, të puthim dhenë e Shqipërisë, për të cilën na ka dëshiruar zemra. (Ulet e puth tokën. Pas tij dhe Mihali. Djemtë presin në këmbë. Çerçizi ngrihet ngadalë, merr një grusht dhë në pëllëmbë dhe me një gjest të madhërishtë thotë.) E rëndë shumë vjen, moj baltë, por paç fatin të lehtë.

MIHALI — Për këtë fat të mëmëdheut përpiqemi, kapedan. Qëllim ynë është qëllim kryengritës.

ÇERÇIZI — (Shpërndan baltën rreth e rreth.) Na qof-

të dhe lufta e mbarë, djema, siç na është e bardhë zemra!

GODOJA E SIRATI — Kështu do të na jetë, kapedani!

MIHALI — (I mrekulluar nga bukuria e vendit.) Vend i bukur, mor Çerçiz, veshur me pemë e mbuluar nga bari.

ÇERÇIZI — Bregu i vendeve ku kemi qenë nuk është më i bukur. E këto nuk kanë as lirinë. Si do të jenë këto, kur të bëhet Shqipëria!

GODOJA — Ti, Mihal, i sheh për herë të parë, kurse kapedani i ka shkelur këto vende.

ÇERÇIZI — Në gjithë këtë krah shtrihen fshatrat e Bregut. Më tej, ku fillojnë malet, janë fshatrat e Labërisë dhe të Gjirokastrës.

MIHALI — Pas bukurisë së vendit janë stolitur edhe njerëzit, besoj.

ÇERÇIZI — Dhe me erë rritesh këtu! Eh, mor vëllezër, sikur të kishin gojë këto vende, ç'do tregonin!

(Dëgjohet një fyell i largët dhe i ëmbël.)

MIHALI — Ja! Të jetë zëri që na the, Çerçiz?!

ÇERÇIZI — Një fyell dëgjohet nga mali.

GODOJA — Më bëhet se afrohet për këtëj.

SIRATI — I bie ndonjë bari.

MIHALI — E po kjo është këngë nga ato që të ngrenë në qiell!

ÇERÇIZI — Pas melodisë ky fyell është i ndonjë labi.

MAJKOJA — Të këtë ardhur labi gjer këtu?!

GODOJA — Këtëj dimërojnë bagëtinë. Bëhen përzi-tës¹⁾ me bregasit.

MAJKOJA — Mirë thua, Godo.

1) përziejnë bagëtitë.

- ÇERÇIZI — (Vë dylbinë.) Bari është, dhe mirë e njoha nga fyelli që është lab, se i shoh bërru-
cën mbi krahë. Hidhu, Godo, e bëji zë.
- GODOJA — (Del dhe thërret.) E... e! (Fyelli hesht.)
- ÇARÇANI — E cili je ti, ore!
- GODOJA — Milk, ore, mik!
- ÇARÇANI — Meqë je milk, ja, zbrita.
- ÇERÇIZI — Dyert e shtëpiye janë të hapura për
miqtë. Le pastaj kur është fjala për qëllime
kombëtare.
- MAJKOJA — Hiç merak mos kini, kapedan, njerë-
zit janë djegur për lirinë.
- ÇERÇIZI — Fole mirë, Majko. (Vjen Godoja dhe ba-
riu.)
- ÇARÇANI — Mirë se rrini, burra!
- ÇERÇIZI — Mirë se erdhe, more shok, e të lumshin
këmbët. Si je?
- ÇARÇANI — Mirë. Si jeni ju?
- ÇERÇIZI — Mirë, shumë mirë jemi.
- TË TJERËT — Mirë, mirë.
- ÇERÇIZI — Si të doli bagëtia nga dimri?
- ÇARÇANI — Mirë, mirë doli. Ky mot filloi mbanë.
Koha ngrohet. Presim behar të mirë.
- ÇERÇIZI — Beharofshi gëzuar!
- ÇARÇANI — Faleminderit! Këto ditë do t'i ngremë
dhëntë e do vemi në malet tona.
- ÇERÇIZI — Vafshi shëndoshë! Lab qenke?!
- ÇARÇANI — Nga fshatrat e Gjirokastres. Po edhe ti
andej duhet të jesh, se të njoh nga opingat e
kuqe që ke në këmbë.
- ÇERÇIZI — Mirë e ke, andej jam.
- ÇARÇANI — Po këta shokë?

ÇERÇIZI — Mihalini e kemi nga Korça. Djemtë nga anët tona.

ÇARÇANI — Qofshin të nderuar ngado që janë!

MIHALI — I nderuar qofsh edhe ti, or vëlla!

TË TJERËT — I nderuar!

ÇARÇANI — Ju faleminderit! Ti i kujt je nga Gjirkastra?

ÇERÇIZI — I Topullarajve jam, i Ago Topullit.

ÇARÇANI — I Ago Topullit, the?

MIHALI — E ke dëgjuar?

ÇARÇANI — Dëgjuar e kam. Topullarajt janë derë e lashtë. Edhe ata mbajnë bagëti e bie puna që lidhim fjalë kur hamë malin. (Çerçizit.) Të zë malli, besoj, për këto të shkreta.

ÇERÇIZI — Më merr malli, vërtet.

ÇARÇANI — I madhi je i Agos, se sikur jeni shumë?

ÇERÇIZI — Dymbëdhjetë vëllezër. Unë kam të tjerë mbi vete.

ÇARÇANI — Vëllait të madh, ia kam dëgjuar zënë. Ka dalë maleve, thonë, e kërkon Shqipërinë.

MIHALI — Edhe ne nga të malit jemi. Kapëdan kemi nga Çerçizin.

ÇARÇANI — E paçi me jetë, or djema, e ju qoftë e nderuar lufta. Po nga dolët këtu?

MIHALI — Çerçizi dhe unë ishim në Evropë. Takuam Bajon dhe shikuam nëpër patriotë. Këta djem erdhën e na pritën në det. Stuhia na hodhi këtu.

ÇARÇANI — E pashë, ngrihej vala si mal.

MIHALI — Po djemtë s'pyetën ama, për inat të detit e qiellit bashkë.

ÇARÇANI — Jeni kryengritës.

ÇERÇIZI — Lirinë e Shqipërisë kërkojmë.

ÇARÇANI — Mirë e keni, or djema. Shqipëria është

baltë e vjetër shumë. Ajo ka qenë më përpara,
më pas u zu njeriu. Ndaj e ka hak lirinë.

ÇERÇIZI — Fjalë të pjekur flet zotrote.

ÇARÇANI — Kur të vish ti në moshën time do flasësh fjalë edhe më me vend. Pastaj, ju që tani
jeni pleq nga mendtë, gjersa keni marrë rru-
gën e pushkës.

ÇERÇIZI — Në themi se kjo rrugë e shpëton Shqipërinë nga Turqia.

ÇARÇANI — Turqi e zezë! Në çdo hap ka lënë plagë.

ÇERÇIZI — Tani Shqipëria u ngrit.

ÇARÇANI — (Bën shenjë me dorë.) U ngrit, Çerçiz,
(bën dërmën Turqisë!)

MIHALI — Me popull bashkë.

ÇARÇANI — Ashtu, me popull. Tani do vini në stan,
apo jeni për rrugë, si e keni?

ÇERÇIZI — Do nisemi!

ÇARÇANI — Jeni për larg?

ÇERÇIZI — Për Gjirokastër e kemi.

ÇARÇANI — Është ca larg. Këmbë të lehta e rrugë
të mbarë, po më prisni pak këtu, u hodha unë
një vrap. (Flet me të fortë.) Begë, ho Begë!
Leri deshtë tani dhe eja mbaj këta miqtë me
muhabet. Dëgjove? O Begë! Lëri deshtë e ulu
poshtë! (Ai del. Vjen Begë Leskoja. Ky është
një djalë, i ri, tepër i fuqishëm, që nuk njeh
jetë tjetër, veç asaj të malit. Është i gjithi në
zi; krahëve ka, hedhur lëkurçe. Është i kuqur
e tërë djersë, merr frymë me të shpejtë. Çer-
çizi me shokë e shohin e habiten.)

ÇERÇIZI — Si je, djali i çobanit?

BEGA — Nuk jam djali i çobanit.

ÇERÇIZI — Po i kujt?

BEGA — I ashjeriu.

ÇERÇIZI — Si, nuk ke baba?

BEGA — Nuk kam patur kurrë as memë e as babë.

ÇERÇIZI — Të gjithëve një memë e një babë na ka prurë në këtë botë.

BEGA — Unë njoh vetëm shiun dhe erën.

ÇERÇIZI — E po ty s'të ka bërë shiu dhe era.

BEGA — Ajo më ka bërë, se turku më ka vrarë babin (banë).

ÇERÇIZI — Epo, na thua, atëherë, i kujt je? Apo kujton se na dhimbset turku?

BEGA — Juve s'e di, por unë për vete jam gjakëtuar me Turqinë, ndaj mos më nga në këtë krah.

ÇERÇIZI — Është një kohë kur ky gjak merret lentë. Dhe ne për këtë jemi maleve.

BEGA — Ju ka vrarë njeri?

ÇERÇIZI — Na ka prishur Shqipërinë?

BEGA — A, jo, unë jam për tjetër.

ÇERÇIZI — Për të njëjtën jemi, po eja më jep dorën.
(Çerçizi e afron.)

BEGA — Të të jap faqen, se dorën e kam më djersë e erë bagëtie.

ÇERÇIZI — Pse, ç'bëje?

BEGA — Matesha me deshtë.

ÇERÇIZI — Si?!

BEGA — Ndërsej deshtë përcorë të Çarçanit dhe mundem me ta.

ÇERÇIZI — Ore Mihal, ore djema, dëgjoni ju a s'dëgjoni?!

MIHALI — Për nder, Çerçiz, më duket si në lexim.

ÇERÇIZI — Po i vë poshtë, a të vënë?

BEGA — Në fillim më vinin ata, tani tre të bëhen bashkë, s'më kthejnë dot as krahun.

(Naxjerr nga rrobat një bri të thyer.)

ÇERÇIZI — Ua thyen brirët?!

BEGA — Kur nuk bien lehtë, edhe ua thyej. Tani, në qoftë se ke atë mëri që the me turkun, eja vemë këtë bri që ngjan si shenjë e tyre, (Tregon bririn e thyer si gjysmë hënë) dhe qëllojmë mbi të. Ti me plumb e unë me gurë. Apo s'të punojnë ato revole që mban në brez?

GODOJA — Ore, djalë i shiut dhe i erës, Çercizit, kur nxehet, edhe revolet në brez i shkrepin vetë.

MAJKOJA — Mos ha inat me kapedanin.

SIRATI — Çercizi e shkon plumbin në unazë.

ÇERÇIZI — Lereni, djema.

BEGA — Atë s'e di, por po deshe turkun, ja ku e ke. (Tregon prapë bririn.) Eja bëjmë kush e ka hasmërinë më të egër. Apo s'do me plumb? Do të mëtemi nga meset?

ÇERÇIZI — Si të duash. Po mirë e ke, eja rrokemi si burrat. (Mbërthehen me njëri-tjetrin. Çercizi bën shaka me të. Begë Leskoja jep e jep e s'e thyen dot. Kështu të përqaftuar i gjen bariu që hyn me mish, dy napa djathë, duhan, një copë borë, etj.)

ÇARÇANI — Na, na, more Begë Leskoja, dhe me të birin e Ago Topullit e vure? (Çercizi e Bega ndahen e shohin nga ai.)

BEGA — Pse, ç'është i biri i Ago Topullit?

ÇARÇANI — Kapedan është. Ja, komandon këta e shokë të tyre. Ti kë ke në komandë?

BEGA — Vetën. I dal vetë zot gjakut të babës. Do shkël mjekrën e ndonjë pashai e do t'u vë zjarrin sarajeve e le të vdes. S'më duhet komanda.

ÇERÇIZI — Bega është djalë guri Trimëri e tillë na duhet.

ÇARÇANI — (Begës.) Tani takohu me këta shokë. Prapë do piqemi, se maleve e shkojnë dhe këta.

BEGA — (Çerçizit.) Herë tjetër kur të piqemi do të të vë poshtë. Ndryshe s'e dua vetën.

ÇERÇIZI — Mirë. Tani eja ndahemi si miq! (Takhën.)

BEGA — Meqë jeni kundër turkut, xhadja e mbarë e dnidhni vendin, kudo që të shkelni! (Bën të dalë.)

ÇERÇIZI — Dhe ti me nder.

BEGA — Do piqemi e do matemi prapë.

ÇERÇIZI — Do piqemi e të dy tok do t'u shkulum mjekrat pashallarëve. (Qeshin.)

ÇARÇANI — Ik, o Begë, ik, o shejtan.

ÇERÇIZI — Ç'e ke?

ÇARÇANI — Është i biri i Lesko Kaçakut me nam.

ÇERÇIZI — I Lesko Kaçakut?!

ÇARÇANI — Babanë ia ka prerë Turqia. Trupin ia bënë feta-feta dhe kokën ia dërguan me sini në Janinë. Shih të birin e mendoje vetë.

ÇERÇIZI — Furtunë!

ÇARÇANI — Unë e kam marrë dhe e kam rritur në sisë të deles. Në s'i ardhte vdekja në rrobe e në gjumë, s'ka për të vdekur nga plumbi. Ta kisha timin do t'ua jepja.

ÇERÇIZI — Do vijë vetë të na gjejë.

ÇARÇANI — Ashtu qoftë! Tani merrini këto, se jeni për rrugë.

MIHALI — Po ipse, or mik, harxhohesh?

ÇARÇANI — Mos u tremb, o korçar, se nuk më bën

zarar të madh. Pastaj, sos m'u kthyet në stan.

ÇERÇIZI — Të faleminderit, mor vëlla,

ÇARÇANI — Ju shoh të mbathur lehtë. Guri të grina
(Heq opingat.)

MIHALI — Jo, jo.

ÇARÇANI — T'i kini ju që jeni për, larg e për punë
të madhe, pa unë therr një mish, thaj lëku-
rën e ja, u mbatha.

ÇERÇIZI — Shumë borxhe po na vë.

MIHALI — Edhe ne, ama, do na pranosh të të bëjmë
një dhuratë.

ÇARÇANI — Po jua pranoj, more djem.

MIHALI — (Nxjerr nga trasta e fishekëve një abe-
tare.) Është libri i gjuhës sonë. (Çarçani me
një respekt të veçantë merr librin në duar dhe
e hap.) Evëtoje i, kanë thënë në mote, sot i the-
mi abetare.

ÇARÇANI — (Sheh nga Çerçizi.) Oje Çerçizi!

ÇERÇIZI — Dëgjoje Mihalin!

MIHALI — Kjo është germa e parë, a-ja, Kjo b-ja.

ÇARÇANI — Mihal-djali, këto shenja janë gjuha që
flas?! Bre, bre, çudi!

MIHALI — Ky është alfabeti i Naimit.

ÇARÇANI — I Naimit të Frashërit?

MIHALI — Naimi me shokë krijoi shoqërinë e gju-
hës, siç krijoi Bajua tani afër shoqëri për armë.
Shoqëri të shkronjézave shqipe, i thonë. Naimi
i mbloodhi shkronjézat një nga një, si yjet në
grushta.

ÇARÇANI — A, m'i lumtë! Ai ka qenë i ditur, kam
dëgjuar, dhe s'e ka bërë kot këtë. Dihen të
mësuarat, pa është lodhur Naimi i Frashërit,
se qe i mençur ai.

MIHALI — Turqia edhe shkronjat tona i ndjek njësoj
si komitët. Po prushi atyre s'u shuhet.

ÇARÇANI — Të keqen e fjalës së mirë që flet, o
Mihal. Ma bërë dhe ti një borxh.

MIHALI — Borxh ia kemi Shqipërisë!

ÇARÇANI — Ashtu, Mihal djali, ashtu! Vetëm një
gjë më trego këtu. Më thuaj kuni është
L-ja. (*Mihal hap librin dhe gjen gërmën L.*)

MIHALI — Kjo këtu!

ÇARÇANI — Aty më rri. Kjo më duhet. Me këtë do
filluar, se me këtë shkruhet fjala Liri. Kjo
është fjala e parë e shqiptarit.

ÇERÇIZI — Ashtu!

MIHALI — Mirë e ke, o vëllai im. Tani është kohë e
lirisë.

ÇARÇANI — Këtej do filluar.

MIHALI — Mësoje gjuhën që flet e këndon. Më-
sojua shkrimin nipërve dhe mbesave.

ÇARÇANI — (Mihalit.) Më rrofsh, o Mihal! (*Të gji-
thëve.*) Ju po më jepni sy tani në pleqëri, mo-
re djem! Ju faleminderit.

ÇERÇIZI — I nderuar qofsh gjithmonë! (*Çeta tako-
het me plakun.*)

ÇARÇANI — Do të niseni? Kjo rrugë merr fshatrat
e Bregut. Kjo rrugë merr Vlorën. Ju i bini kë-
tej. Këtej del për në fshatrat tona. (*Ata bëjnë
të nisen.*) Ju qoftë rruga dielli, or trima! E
dëgjo, o djali i Ago Topullit! Unë jam Çarçan
Mazja nga Kurveleshi. Jam baba i gjashtë
djemve e njërin ta kam falur.

ÇERÇIZI — Të faleminderit, o Çarçan Mazja!

MIHALI — Të lumtë goja, o plaku i mirë!

ÇARÇANI — E kështu, o djemtë e mi. Shtëpinë ua

...kam bërë strehë e jatak e jetën e djalit ia kam
 dhënë luftës suaj. Kështu, o djali i Ago To-
 ...pullit, o Çerçiz!

ÇERÇIZI — Djemtë të të rrojnë e të të nderojnë!

ÇARÇANI — Të më rroni edhe ju. Ti rroni Shqipë-
 risë!

ÇERÇIZI — Rroftë Shqipëria! Rroftë kryengritja e
 ...saj!

(Muzikë, kënga «Për mëmëdhenë». Përdj.)

...
 ...
 ...
 ...
 ...

...
 ...
 ...

...
 ...
 ...

...
 ...

...
 ...
 ...

...
 ...
 ...
 ...

...
 ...
 ...
 ...

KËNGË EPIKE

Bajo ç'u ngrite e vajte,

brenda në Evropë,

— Shqipëria është me vullë

qëkur është zënë kjo botë.

— Ulu në skami të lartë

të llofosemi.

— Nuk kam kohë për t'u ulur,

kërkoj Shqipëri.



S K E N A II

Në komitetin kombëtar të Gjirokastrës.

Ambient klubi i shoqërive patriotike të fillimit të shekullit. Një portret i madh i Skënderbeut. Anëtarët janë aty. Kapo përfaqëson kryetarin e komitetit. Muhedin bej Koko, tepër i shëndoshë dhe që i merret goja, është nga brezi i parë i parësisë shqiptare lidhur me Turqinë. Alem Libohova është përfaqësues i shtresës së re të kësaj parësie, tepër i shkathët dhe që u përshtatet situatave, vetë goja e Muhedin bej Kokos.

KAPO — Ç'thua ti, Muhedin bej?

MUHEDIN BEU — (Me vështirësi, se i mernet goja.)

U... u... unë them se asnjë komitet s'mund ta kthejë Shqipërinë.

KAPO — Pse?

MUHEDIN BEU — Se... se... se... Shqipëria s'mund të prishë Turqinë.

KAPO — Komitetet për lirinë e Shqipërisë thonë se e prish, ti pse thua jo.

MUHEDIN BEU — Po...po... (Lodhet e djersin nga vështirësia për të folur.)

ALEMI — (Del që pas tij dhe i merr fjalën, si njeri i shkathët i dinakërisë dhe prapaskenës.) Se Turqia, thotë Muhedin beu, është mbretëri e madhe, zoti Kapo. Shqipëria është a s'është sa një vilajet i saj.

KAPO — Ashtu, po Shqipëria ka treguar se bëhet më vete.

MUHEDIN BEU — Po... po... emri Shqi.....

ALEMI — Emri Shqipërisë i është dëgjuar me Turqinë.

KAPO — I është dëgjuar kur ka dalë kundër Turqisë.

MUHEDIN BEU — E... e... k...

ALEMI — E kur?

KAPO — Skënderbeu bëri Shqipëri e prishi Turqi.

ALEMI — Mbretëri e madhe ajo.

KAPO — Mbretëri në rrokullime. Kurse Shqipëria është e freskët si mëngjesi. (Anëtarëve të tjerë.) Apo jo?

NJË ANËTAR — Dritë.

NJË ANËTAR TJETER — Dritë.

KAPO — Ajo që do të bëjmë, do të jetë Shqipëria zonjë.

ALEMI — E si do të bëhet kjo Shqipëri?

KAPO — Nga shqiptarë liridashës.

ALEMI — Shqipëri me fjalë?!

KAPO — Me ndjenja mëmëdhetare. Komitetet do përhapin mendimin e Shqipërisë. Do ngrenë klube e do hapin shkolla.

ALEMI — Gjuhë e dituri ka Turqia, më shumë se ne ka.

KAPO — Ne do shohim mbrothësinë e gjuhës sonë. E

tok me gjuhën do luftojmë edhe me pushkë.
Komiteti do të ketë çetat e tij. Këtu rreth do të
jetë Çerçizi.

ALEMI — Ku është Çerçiz Topulli?

KAPO — Ka vajtur ngushëllon te Grigor Lekli.

ALEMI — Ë... ë...

KAPO — Pse e vranë dhaskal Grigorin dhe pse e varrosën pa një këmbanë?

ALEMI — Pse?

KAPO — Pse kanë frikë nga librat dhe shkollat. Dituria i tremb njëlloj si trimëria.

MUHEDIN BEU — Pa... pa..

ALEMI — Parësi e Shqipërisë është lidhur me turqizmen.

KAPO — Do ta bëjnë ata që s'janë lidhur me Turqinë.

MUHEDIN BEU — Një... një...

ALEMI — Një vend gjithmonë dëgjohet nga oxhaqet.
Si u bëka një vend pa dyert e mëdha?!

KAPO — *(Rreptë.)* Oxhaqet që e duan mëmëdhenë,
bujrum, të vinë ta bëjnë. Ja, si e bëjnë dyert e vogla.

ALEMI — Dyert e vogla?

KAPO — Populli nuk e ka humbur fuqinë e shpirtshme. Ai zjarr do ta bëjë Shqipërinë. *(Pauzë.)*
Parësia e ka harruar vatrën, po vatra bubullin akoma.

MUHEDIN BEU — O... o... va...

ALEMI — O, vatra! Zoti Muhedin bej thotë se oxhakun e madh e bën paraja. Qesja është në dorë të parësisë. Arka e komitetit është e thatë trokë. Si bëhet kjo vatrë kështu?

(Dëgjohe zëra.)

— Unë vë për komitetin pesëdhjetë lira.

— Unë njëqind.

— Unë jap tridhjetë kokë dhen.

— Unë një nga dyqanet.

KAPO — E, zoti Muhedin?

MUHEDIN BEU — Tri... tri...

ALEMI — Tridhjetë kokë dhen, një dyqan!

SITKI ÇOBOJA — Mos na qesh, zoti Muhedin, apo se
i ke sarajet me qelqe, zotrote?

MUHEDIN BEU — Me... me...

ALEMI — Me qelqe i kam, i ka zotëri e tij.

SITKI ÇOBOJA — Parësi e Gjirokastrës, Muhedin
bej, ka para sa ta veshë këtë komitet me flori.
Po thuaj sa ia dëgjojnë hallin mëmëdheut.

NJË ANËTAR — E dëgjojmë ne.

MUHEDIN BEU — Ti, ti....

ALEMI — Ti, Sitki Çoboja, bëj një herë shtëpi e hidh
pasuri, pastaj mendo më tej.

SITKI ÇOBOJA — S'më ha aq merak i shtëpisë, sa ai
i Shqipërisë, Alem bej.

ALEMI — Dhe ti, Sitki Çoboja thua se një kaza i rri
dot ballë Turqisë?!

KAPO — Gjithë vilajetet po të bëhen njësh.

SITKI ÇOBOJA — I rrinë, Alem, i rrinë. (*Hyn arkë-
tari i komitetit dhe i jep një telegram Kapos.*)

ARKËTARI — Ma dhanë në telegrafë. Shemo Hajroja
më pa në rrugë e më ktheu.

KAPO — (*Pasi e hap dhe e sheh.*) I lumtë! Mëmë-
dhetarë! Telegram nga komiteti i Korçës.
(*Brohoritje aprovuese.*) Dëgjoni ç'shkruan
Korça, mëmëdhetarë! «Urojmë komitetin e
Gjirokastrës. Punofshi si atdhetarët e qëmot-
shëm! Qëllimin e kemi një, ndaj të bashkojmë
punët.» Jetë të gjatë komitetit të Korçës!
(*Brohoritje.*) Përpjekësit për Shqipëri janë

shtuar kudo. Ja Korça. Kështu dhe Gegëria.
Shqipëria e tërë lëviz.

ANËTARËT — T'u a kthejmë urimin!

NJË ANËTAR — Telegrafa t'u çojë fjalë se për çdo punë do merremi vesh.

TË TJERËT — Bashkë, bashkë!

KAPO — Që kur është hapur çështja kombëtare, Gjirokastra i ka dhënë asaj djem. Më 78-tën, komiteti ynë e mbështeti Lidhjen e Prizrenit dhe e ngriti popullin. Gjithë sanxhaqet e Jugut vulosën mandatet e qeverisë kur erdhi Abdyl Frashëri. Kemi shembulla për mirë. Dhe tani që erdhi sahati të bëhet Shqipëria, Gjirokastra s'ka për t'u kursyer. Apo jo, mëmëdhetarë?!

ANËTARËT — Nuk do të kursehem.

(Dëgjohen zërat e anëtarëve të komitetit kombëtar.)

Rroftë Liria!

— Rroftë flamuri i Skënderbeut!

— Shqipëria do të bëhet!

— Jemi me Bajon dhe gjithë klubet kombëtare!

KAPO — Komiteti që bëmë do të punojë për problemin kombëtar e tok me të tjerë do të përpiqet për lirinë e Shqipërisë. Lëvizja shqiptare thotë se do të bëjmë një Shqipëri autonome.

(Zërat e anëtarëve.)

— Ashtu, ashtu.

— Shqipërinë e duam me mvehtësi nga Turqia.

— Duam veturdhërimin nën flamur të Skënderbeut.

— Rroftë flamuri i Skënderbeut!

— Rroftë!

KAPO — Të gjithë mëmëdhetarët të bëhemi të një mendjeje, kur është fjala për Shqipërinë.

SITKI ÇOBOJA — Mirë, Kapo, po disave s'u ndahet shpirti nga baba sulltani. (Reagim.)

MUHEDIN BEU — Si... si... si... the ti, Sitki Çoboja?

SITKI ÇOBOJA — (Me ironi.) Të kemi sulltanin, thashë, të na rrojë.

MUHEDIN BEU — Fjalë të dredhura s'dua.

SITKI ÇOBOJA — Ashtu them dhe unë, të tillë s'duam. (Alem Libohova shket nga debati i tyre.)

MUHEDIN BEU — Ç'eshtë ashtu?! S'mbaj mend të më jetë kthyer fjala.

SITKI ÇOBOJA — Fjalët e prapa kthehen mbrapsh.

MUHEDIN BEU — Mua jo, se unë jam oxhak. Dhe brezin e kam plot. (Bën të nxjerrë revolen Sitki Çoboja gjithashtu. Edhe Kapoja ka hedhur dorën në kobure. Muhedin beu është ngatërruar e ka hequr në vend të kobures një portofol të madh. Reagim.)

SITKI ÇOBOJA — Ajo para nuk të vret, Muhedin bej. (I tregon koburen e vet.) Kurse kësaj, ruaju. (Alem Libohova ka dalë nga dera. Muhedin beu, më me ngathtësi, del edhe ai. Hyn malësori Oso Vranja dhe plaku Guro. Malësori është i 1800-tës, tani 100 e ca vjeç, tepër epik. Ka jetuar kur sulltani shpalli fermanllinj Bushatllinjtë e Shkodrës, ka marrë pjesë në shumë lëvizje popullore. Në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ka qenë shoqërues i Abdyl Frashërit nga Stambolli në Prizren e nëpër 7 kryeqytetet e Evropës; ka pritur plumbin e tij në një nga atentatet që i kanë bërë pashallarët e Lidhjes. Një dorë e ka të vrarë e të paralizuar nga plumbi. Ka mbetur në Gjirokastrë që kur vinte Abdyl Frashëri për Komitetin e Lidhjes dhe për shërbimet e tjera në

Jug, si anëtar i qeverisë së Prizrenit. Gëzimi i tij janë kuvendet dhe besëlidhjet shqiptare. Plaku Guro është më i ri, i shkathët dhe mban në duar bastun alegorik. Anëtarët ngrihen me respekt.)

KAPO — Urdhëroni! Urdhëro, baca Oso, këtej! Urdhëro dhe ti, zoti Guro!
(Kapo merr dhe drejton për tek vendi Oso Vrenjën.)

OSO VRANJA — Të falemnerës, Kapo, më rrofsh! Po, he, or djelm?! U ngrit prapë ylli i Shqipnisë?! U ngrit, besa.

KAPO — Përpiqemi, baca Oso, nën shembullin tuaj, të të parëve.

OSO VRANJA — Të përpiqeni, or djelmtë e bacës. Kur erdhi Abdyl Toska prej Stambolli e çova te shpija e Mic Sokolit. Ishte Sulejman Vokshi aty. Sulejman Vokshi i tha burrit të Shqipnisë se tanë Kosova ishte gati me deklë. Deri edhe çikat, u hodh Mic Sokoli. Aq foli. Nji aq foli dhe kur ra mbi top të turkut.
(Anëtarët reagojnë.)

KAPO — Komitetin e ngritëm, baca Oso.

OSO VRANJA — Besëlidhjet kanë qenë jeta e Oso Vranjës, të besëlidhunit vllaznit e mi. Ka parë Oso Vranja boll kuvende, po kjo besa-besë tash e gëzon tjetër lloj. Njësh kena me u ba, toskë e gegë. Shqipnia e ngriti pushkën prapë.

KAPO — Bashkë, toskë e gegë.

(Zëra.)

— Bashkë!

— Bashkë!

— Do ta bëjmë Shqipërinë.

— Nuk e lemë.

— Jo!

OSO VRANJA — Shqipëria për ne asht qielli e dheu. Ngrejeni, o djelm, se zemra ma thotë se ka ardhë sahati i saj. (*Hesht.*) Jam plak e fola boll. Ndigjoni dhe Guron që asht djalë.

KAPO — Urdhëro e fol, zoti Guro!

PLAKU GURO — Plaku Guro do tregojë, ka zakon e s'flet me gojë. Meqë doni mend nga unë urdhëro e fol, bastun!

(*Ngre bastunin lart. Anëtarët shohin me vëmendje. Plaku Guro në kokë të bastunit ka gdhendur një grusht të shtrënguar. Gishti i madh dhe dëftues janë para, sikur kapin lapsin ose shkrehin pushkën.*)

NJË ANËTAR — Ç'thotë bastuni, zoti Guro?

PLAKU GURO — Bastuni thotë se Shqipëria bëhet kur ne jemi të bashkuar. Ja, si gishtat në dorë. Bashkë me bashkimin duhet lapsi. Bashkë me lapsin gishtat duhet të dinë edhe pushkën, thotë bastuni. Hop, tërhiqet pak gishti dhe arma shtie. Kështu thotë bastuni. Dhe bastuni është i vjetër mbi dhe. Dhe është prerë në male lart. Zemrën e ka në tokë bastuni, ndaj i do dëgjuar fjala.
(*Zëra.*)

— Të kuptuam, zoti Guro.

— Qartë.

— Ta morëm mendjen.

PLAKU GURO — Nuk është mendja ime, kështu thotë bastuni.

NJË ANËTAR — Po bastunit ti ia jep gjuhën, zoti Guro.

PLAKU GURO — Gishti, thotë bashtuni, duhet gishti! Kështu, Kapo! (*Mbledh gishtat e tij.*) Gishti bën gram, gishti bën bam. (*Kalon midis anëtarëve. Hyn një lajmës.*)

LAJMËSI — Po vjen Çerçizi si era. *Hyjnë Çerçizi dhe Mihali. Klubi gjallërohet.*)

ÇERÇIZI — Mirë se rrini, patriotë!

MIHALI — Mirë se ju gjejmë!

KAPO — Mirë se erdhët!

NJË ANËTAR — Ju lumshin këmbët, Çerçiz e Mihali!

ÇERÇIZI — Baca Oso, ti këtu?!

OSO VRANJA — Po besa, më çoi drita e Shqipnisë, Çerçiz o bir.

ÇERÇIZI — Dritë të qoftë pleqëria, Oso Vranja. Kemi nevojë për ty.

OSO VRANJA — Shqipnia ka nevojë për ty e për këta djelm. Po hajde, takohena si burrat. (*Takohen sipas zakonit të malësisë.*)

ÇERÇIZI — (*Afron Mihalin.*) Ky është Mihal Gramevoja nga Korça.

OSO VRANJA — (*Rroket dhe me Mihalin.*) Mihal me halle qenka, gjersa ju jeni bërë tok.

PLAKU GURO — Çerçizi, Mihali dy

bobo ç'janë të këqi,

bëjnë luftë me osmanlli

turpërojnë goxha Turqi.

(*Dëgjohen zëra.*)

— Të lumtë goja, plaku Guro!

— Të lumtë ai zë!

— Si dora, goja!

PLAKU GURO — Si zemra, goja!

KAPO — (Çerçizit e Mihalit.) Si i latë njerëzit e të ndjerit?

ÇERÇIZI — Zi e madhe, ndaj mbetëm aty mbrëmë.

KAPO — Vrasje e rëndë, prapa krahëve.

ÇERÇIZI — U premtuam të afërmve të mëmëdhetarit se hakun do t'ia marrim ne, Mihali dhe unë.

KAPO — Ju takon, si miq e si kombëtarë.

ÇERÇIZI — Qafsha Bajon, në s'ia marrshim gjer në një.

KAPO — Muhedin bej, Alem! (I kërkon.) Ku janë?

NJË ANËTAR — Kanë dalë.

SITKI ÇOBOJA — Ikur, thuaj.

NJË ANËTAR — Kërkoj në klubin turk a grek.

NJË ANËTAR TJETËR — Prapa diellit.

KAPO — Ne që jemi, të jemi grusht. Kështu! (Aprovim.)

MIHALI — Çerçizi do mbajë fjalë po jashtë presin edhe djem të Gjirokastrës që na u lutën t'ia marrim në çetë. Unë them le të vijnë.

ÇERÇIZI — Të vijnë, edhe pse janë shumë të rinj për t'u ulur në krahë të këtyre burrave.

KAPO — Të vijnë, Çerçiz, të vijnë. (Hyjnë djemtë e rinj që janë gati të hidhen me çetën.)

ÇERÇIZI — Mëmëdhetarë trima! Gjithë këto ditë u dëgjua fjala jonë. Bisedimet që bëmë janë për të pritmen e kombit. Shqipëria kërkon lirim nga osmanët. Unë them se duhet kryengritje. Koha është trimërore. Kush do të vijë me çetën?

(Aprovojnë, djemtë e rinj gëzohen, çohen në këmbë.)

— Unë.

— Unë.

— Të gjithë.
— Të rrojë liria!

(Mblidhen rreth Çerçizit gati për t'u nisur e për të mbetur në luftë.)

OSO VRANJA — Po gjallet Shqipnia, besa po gjallet!
E trashëgofshi, djelm!

PLAKU GURO — Një Çerçiz e një Mihal!
bien rrotullë kazanë
dil, pasha, të shoç shqiptarë,
të qepin plumbat në ballë.

(Errësim; ngadalë bie perdja.)

KËNGË EPIKE

Vjen fermani nga larg:
Më zini Çerçizin gjallë;
Çerçizi nuk zihet gjallë
se ka bërë nënia djalë.

SKENA III

Në prefekturën turke.

I ARDHURI NGA JANINA — Mytesarif i Gjirokastrës, unë vij nga Janina, po në këmbën time një ditë mund të vijë një tjetër nga mesi i mbretërisë.

PREFEKTI — Zoti i dërguar i Valiut të madh, ushtari besnik i sulltanit ka vite që e bën karrierën e tij në tokë të shqiptarëve. Ata flasin pa dredhitë e nënkuptimet e gjuhës së allahut. Cili është mendimi juaj, zotëri i nderuar?

I ARDHURI NGA JANINA — Nesër, pasnesër, po ta lesh gjëndjen kështu, vjen i dërguari i Stambollit, ose më keq, fermani i sulltanit dhe ti nuk ke kohë të sqarohesh dot. Mbretëria është e madhe vërtet, po fermani vjen shpejt. Mbretëria është e madhe, ka edhe vendet e shkreta të rërës.

PREFEKTI — Nuk mund të ma thoni më qartë?

I ARDHURI NGA JANINA — Një pjesë të gjërave, mundet.

PREFEKTI — Atëherë urdhëro e fol.

I ARDHURI NGA JANINA — Valiu do të dijë ç'bëhet në këtë prefekturë të vilajetit?

PREFEKTI — Njerëzit janë ushtarë të allahut dhe vezirit.

I ARDHURI NGA JANINA — Valiu kërkon të dijë gjëra më të thjeshta.

PREFEKTI — Qeverimi ynë është i fortë dhe e ka shtruar vendin.

I ARDHURI NGA JANINA — Edhe këto janë fjalë shumë të përdorura për veshët e valiut. Valiu buzë liqenit rri, por di edhe ç'ndodh maleve e shkrepave të tua. Dhe valiut nuk gabon kurrë në ato që di.

PREFEKTI — *(Duke i shërbyer lëng trëndafili.)* Zoti i dërguar nga vilajeti, nuk bën të flasim më butë e më shtruar?

I ARDHURI NGA JANINA — Sado shtruar të flasim unë e ti, gjendja është kjo. Të kërkohet të shtrosh vendin.

PREFEKTI — Me dëshirën e allahut, forcën e vezirit të madh dhe krahun e valiut, i dërguari i nderuar.

I ARDHURI NGA JANINA — Valiu do të dijë se ç'bëhet në prefekturën tënde, ç'flet Bajram Gjirokastra e ç'kërkon Çerçiz Topulli maleve me njerëz kundër regjimit.

PREFEKTI — Ata janë vetëm hajdutë, i dërguar i nderuar. Njerëzit e kësaj prefektуре, si të tjerë të këtij vilajeti të largët, janë gati të marrin malet e të vriten për një vjedhje, për një fjalë të ndërruar.

I ARDHURI NGA JANINA — Po ata ngrënë klube e duan shkolla. Ata lidhin besën e dalin në çeta. Ata kërcënojnë qeverimin e duan t'i bien qytetit.

PREFEKTI — Fjalë komitash, i dërguar.

I ARDHUR NGA JANINA — Ata kërkojnë edhe mvehtësinë e Shqipërisë nga Turqia.

PREFEKTI — Ohoho... Shqipëria do t'i bjerë Turqisë? Mbretëria, i dërguar...

I ARDHURI NGA JANINA — Mytesarif i Gjirokastrës! Ti e ke dëgjuar, besoj, fjalën e Stambollit që historia e shqiptarëve, po doli në shesh, është prishja e Turqisë.

PREFEKTI — Unë, i dërguar i dërguar, kam marrë dërguar, gjithmonë se në jemi një shtet i madh, ulur pajdash!) mbi botë, mbi turq, kaurë e të bafë.

I ARDHURI NGA JANINA — Gjuha e tyre është një gjuhë e lehtë dhe e plotë. Po ta lemë mund të përparojë shpejt. Sa për pushkën, ti e di që shqiptarët e kanë vit e kryengritje.

PREFEKTI — Po mbretëria, i dërguar...

I ARDHURI NGA JANINA — Mbretëria është e madhe, mytesarif, dhe veziri do të jetë i qetë,

PREFEKTI — Ç'këshillon Janina?

I ARDHURI NGA JANINA — Vendi do shtruar, me hir o me pahir,

PREFEKTI — Si?

I ARDHURI NGA JANINA — Atë e di më mirë ti, se ke vite me arnautë e ballkanas. Ku s'shkon pushka, thika, ku s'shkon thika, helmi, e ku s'shkon helmi, fjala. Më kupton?

PREFEKTI — Të kuptoj, i dërguar.

I ARDHURI NGA JANINA — Dhe ku s'shkojnë të gjitha këto, arnauti kundër arnautit.

PREFEKTI — Nuk do të kursehem, i dërguar i nderuar. Janina mund të na ndihmojë.

1) këmbëkryq.

I ARDHURI NGA JANINA — Ushtria është në rru-
gë e sipër, po ti edhe këtu ke forca boll.

PREFEKTI — Si urdhëron, i nderuar.

I ARDHURI NGA JANINA — Kështu, mytesarif i
Gjirokastrës! Dhe mos harro se mbretëria është
të e madhe. Që ku fillon deti i kripur e deri
ku mbaron rëra e thatë. E mos harro se veziri
i madh vitet e fundit zemërohet kollaj. E mos
harro se në këmbën tënde një ditë mund të vi-
jë një qifut për qeverisje. Allahu goftë me ty!
(Del.)

PREFEKTI — Nga larg erdhe i dërguar i valiut, e
fjalë me kuptim të largët folë. Kercënoni e
të tani bukur nga ligëri i Janinës, po punët kë-
tu janë ndryshe. Ah, Çerçiz Topulli, ose do të
ta krip kokën, ose do të ma kripësh ti mua.
(Përplas pëllëmbët. Hyn një rojë.)

ROJA — Urdhëroni, mytesarif.

PREFEKTI — (I hutuar.) Çerçiz Topullin!

ROJA — (Që nuk kupton.) Urdhëroni, zotni mytesa-
rif?

PREFEKTI — A..., a... të vijë bimbashi e mitropoliti
grek.

ROJA — Si urdhëron, mytesarif. (Rojë del; hyn bim-
bashi dhe mitropoliti grek, qiries Papallambra-
qis.)

PREFEKTI — Mitropolit i ditur dhe bimbash zemër-
hekur! Ju thirra të më thoni se ç'keni men-
duar për lëvizjen e Gjirokastrës dhe Çerçiz To-
pullin. I dërguari i vilajetit sapo doli. Arabaja
e tij s'do ketë kapërcyer as urën akoma.

MITROPOLITI — Zoti, mytesarif i lartë, është zemër-
ruar me njerëzit. Ai ka dalë nga shpirti i nje-

- riut dhe në të ka hyrë djalli. Çerçiz Topulli nuk beson më Muhametin, po djallin.
- PREFEKTI — Kjo është punë e hoxhës, qiries. Ti ç'thua?
- MITROPOLITI — Çerçiz Topulli bashkë me myslimanë, bën me vete edhe të krishterë.
- PREFEKTI — Si, si... e pastaj?
- MITROPOLITI — Të ndajmë nga lëvizja arnautë e të krishterë. T'i mallkojmë, t'i shkishërojmë ata që mbajnë anën e shqipes.
- PREFEKTI — Qiries Papallambraqis, je më i shkahtët se ç'të tregon pamja e më dinak se ç'të jep fytyra.
- MITROPOLITI — Të mirat dhe të këqijat që kemi, për mbretërinë i kemi, mytesarif i lartë.
- PREFEKTI — Fjala e fesë është hashash për besimtarët, qiries mitropolit.
- MITROPOLITI — T'u hedhim anatemen, mytesarif i lartë, t'u trembim jetën në emër të zotit. Atëherë ata do ndahen nga arnautët. Fjala, mytesarif i lartë, hyn edhe atje ku s'hyn shpata e helmi. Fjala shket.
- PREFEKTI — Të dëgjojmë dhe bimbashin trim.
- BIMBASHI — Mitropoliti foli boll, kurse zanati im s'është fjala.
- PREFEKTI — Po prefektura ka nevojë për mendjen tënde.
- BIMBASHI — Zanati im është shpata. Ne jemi dora e mbretërisë.
- PREFEKTI — Po dorën e drejton mendja, bimbash zemërhekur!
- BIMBASHI — Shpata e pret një kokë ku rri një mendje e zgjuar e flet një gjuhë e helmët. Gjuha e pret?

MITROPOLITI — E pret, biri im, e pret.

PREFEKTI — E si thua ti, bimbash?

BIMBASHI — Ky milët do rrahur si daullja e ramazanit. Këta s'i qetëson rregulli. Këta i bën një rrez syrgjynllëku, burgu i zi.

PREFEKTI — Ç'do të bëje, bimbash, zemërhekur, po të të lejonte prefektura të veproje në emër të saj?

BIMBASHI — Në fillim do shkulja shtëpitë e komitëve dhe atyre që i strehojnë. Pastaj do të filloja frikësimin për të gjithë, sepse njëri mos ngrejë kokë të dëgjojë as kur flitet për ta.

PREFEKTI — Trim! Po më?

BIMBASHI — Në fund do mblihdja një mashkull për shtëpi dhe do t'i dërgoja në Jemen. Kjo është puna ime.

PREFEKTI — Rërat e Jemenit, ë?

BIMBASHI — Burgjet, rërat dhe hekuri.

PREFEKTI — Prefektura të lejon ta shkosh këtë në për mend. Do vijë dita dhe ta zbatosh?

BIMBASHI — Ajo do jetë dita ime.

PREFEKTI — Duhet t'ju falënderoj ty, mitropolit i zgjuar e i matur, e ty, bimbash inatluan. Unë e shoh se ju dhimbset fati i prefekturës dhe keni menduar kundër komitëve të rebeluar. Prefektura ka nevojë për të gjithë. Ajo nuk ju harron.

MITROPOLITI — Falënderit, mytesarif i lartë.

BIMBASHI — Jam nën urdhër!

PREFEKTI — Mund të shkoni. (Bëjnë të dalin.) Mos harroni Çerçiz Topullin! (Përplas duart. Hyjnë roja.)

ROJA — Urdhëroni!

PREFEKTI — Nxirrni Alem Libohovën!

ROJA — Po, zoti mytesarif! (Del Alem Libohova që rrinte i fshehur.)

PREFEKTI — I dëgjove të gjitha, beşoj.

ALEMI — I dëgjova gom nosat për të...

PREFEKTI — Për rrugën që mëndon njëri e tjetri, og... ti ç'thua?

ALEMI — Të çajmë knerët, mytesarif.

PREFEKTI — Si?

ALEMI — Politikë e përçarjes dikë dhënë gjithmonë frytë Turqisë...

PREFEKTI — Atë që thotë mitropoli?

ALEMI — Qiries Papallambraqis niset nga çështja fetare. Unë them për knerët e lëvizjes kundër...

PREFEKTI — Alem Libohova, nuk sheh më pak se...

ALEMI — Parësia shqiptare, mytesarif i lartë, s'është...

në gjendje t'i japë Turqisë as një teneqë me...

çifliqet. Të gjithë sulmojnë shkallët e karrierës.

Paraja e çifliqet, mytesarif i lartë, të bëjnë mik...

PREFEKTI — Çercizi kushton...

ALEMI — Unë do të jepja dhe një vilajet...

PREFEKTI — I ditur, trim dhe i bukur. Ah!

ALEMI — Shtegu i parësë dhe i titujve e zë kollaj bishen.

PREFEKTI — Ata që të thashë, i gjete?

ALEMI — I gjeta.

PREFEKTI — Ku janë?

ALEMI — Presin...

PREFEKTI — Të vijnë! (U bie duarve. Hyn roja.) Të vijnë shërbëtorët e zotit Libohova!

ROJA — Si un dhëron!

PREFEKTI — Ua ke gjetur shkakun?

ALEMI — Mund të thonë se i vranë për gjak, ose se u ranë natën në bagëti.

PREFEKTI — Cila është më e rëndë?

ALEMI — E para i rëndon të vrarët, e dyta i ul dhe i poshtëron.

(Hyjnë dy vrasësit.)

PREFEKTI — Sulltani i madh ka nevojë për ju.

VRASËSI I — Gati na keni!

PREFEKTI — Çdo shenjë thike do paguhet një lirë.

VRASËSI II — Sa plagë kërkoni?

PREFEKTI — Sa të qetësohet kjo anë e vilajetit.

(U jep thikat dhe dy qese me para.)

VRASËSI I — Dën atëherë këto thika s'do zbardhin nga gjaku.

VRASËSI II — Të vrarët s'do i njohë as nëna që i ka bërë.

PREFEKTI — Më pëlqën trimëria dhe fjala juaj.

VRASËSI I — Plagët që do japim do të jenë më të mëdha.

PREFEKTI — Ç'hak do lani me to?

TË DY — Atë që na ranë në bagëti.

PREFEKTI — Me dorë të lehtë!

(Vrasësit dalin. Errësohet skena.)

Në penxhere, në Topullarë,

rrri një hënë, rri një vajzë.

Rri një vajzë, rri një hënë

ballin nga meraku zënë.

Balli nga meraku zënë

vjen Çerçizi furtunë,

vjen Çerçizi furtunë

sa i shkon sevda e shumë.

Sevda e marrë ç'të ka hie

Çerçiz — dielli kur bie.

SKENA IV

Rrugë, një pjesë kopshti dhe dhoma e grave në Topullaraj. Në dhomë janë e motra, kunata dhe nusja e Çerçizit. Dy të parat janë në plan të dytë; motra thurr çorape të mëdha leshi, kunata rregullon rrobat në juk dhe në sepete, kurse nusja rri e menduar në dritare, shtyp kafe në gur të kafesë dhe sheh larg. Dëgjohet zallahi e madhe.

ZËRA — Turku, turku!

— Mbyllni dyert, moj gra.

— Ngjitet patrullë e re. Zini penxheret e ulni llambat.

(Dëgjohet kërcitje e dyerve dhe penxhereve që mbyllën. Kalon patrulla me xhandarë turq. Rrinë pak në skenë duke vështruar dritaret e larta dhe pastaj dalin.)

NUSJA — Rrugët i ka zënë turku.

MOTRA — Rri, moj nuse, mës u mërzit.

KUNATA — Turku zë rrugët e qytetit. Ata varen nga mali.

MOTRA — S'e gjen lehtë e keqja Çerçizin.

NUSJA — Ku di unë?!

MOTRA — Ty s'të lë zemra ta besosh, po kështu është, si themi ne. Apo jo, moj kunatë?

KUNATA — Ashtu, motër, ashtu! Vajza është nuse e re dhe i fluturon zemra. Kjo thëllëzë e vëllai luan. Po mos u mërzi, të rrit Çerçizi ty.

NUSJA — S'mërzitem, gjersa jam me ju, po thonë se komiteti i kërkon qeveria.

KUNATA — Hiç mos mërzitesh. Ti je nuse e Çerçiz Topullit. Qeveria le të vejë t'i gjejë. (Dëgjo-het e rëna e një sahati muri.)

MOTRA — Ora ra. Kunatë, bëju gati të dalim në kopsht.

KUNATA — Ja, të marr fenerin.

MOTRA — (E cila shpejt e shpejt maskohet si djalë.) Ti, nuse, rri këtu. Dalim ne. (Kunatës.) Erdhe, kunatë?

KUNATA — (Me një fener në dorë.) Gati!

MOTRA — Ulemi atëherë. Mos u mërzi, nuse.

NUSJA — Jo. (Ato të dyja me fenerin mbuluar me futa zbresin në kopsht. Bëjnë shenja me dritë në mes të pemëve. Sinjali për të ardhur Çerçizi me shokë. Presin pak të shqetësuar. Dëgjojnë hapa në zhur dhe disa gur të vegjël u bien përreth.)

KUNATA — Dëgjove hapa?

MOTRA — Ja dhe gurët. Erdhën! (Çerçizi kërcen në mur dhe vjen tek ato.)

KUNATA — Çerçiz!

MOTRA — Vëlla, erdhe?

ÇERÇIZI — Si jeni të gjithë, mirë?

MOTRA — Mirë, i miri i motrës. (Bën ta përkëdhelë. Ai nuk pranon dhe lëviz me vrull.)

ÇERÇIZI — Lermë!

MOTRA — Të çmallet pak motra.

ÇERÇIZI — Mirë kam qenë.

MOTRA — Të keqen motra, që je kaq i ashpër.

KUNATA — Eja vemi brenda, mbetëm këtu.

MOTRA — Nuk do vijnë të tjerë?... Ku janë të tjerët,
Çerçiz, apo mos ju ndau turku?

ÇERÇIZI — Mihalin e ktheu plaku Guro. Djemtë do
vijnë me të dalë ylli i çobanit.

MOTRA — Të vijnë, o vëlla, të vijnë.

KUNATA — Të bëjmë gati shtrojet e t'i lëmë në pat?

ÇERÇIZI — Bëjini, se s'i dihet.

MOTRA — Kemi njerëz shumë.

ÇERÇIZI — Shtroni dhe në kopsht, si herën e kaluar.

KUNATA — Mirë, Çerçiz.

ÇERÇIZI — Tani, pelës jepini verë dhe lidheni nën
dritaren që rri hapur.

KUNATA — E rregullojmë ne.

MOTRA — Do të të hedhë gjëkund, Çerçiz, do të të
hedhë.

ÇERÇIZI — Do më hedhë në qoftë e zonja.

*(Gratë mbeten vetëm. Çerçizi ngjitet në dho-
mën lart. Nusja, që vazhdon të shtypë kafënë,
nuk e vë re. Ai afrohet ngadalë dhe i bie në sup.
Ajo kthehet me frikë, e sheh dhe gëzohet.)*

NUSJA — Më trëmbe.

ÇERÇIZI — Nuk prisje?

NUSJA — Unë e di si prisja, po dhe rrugët janë plot
me turq.

ÇERÇIZI — Unë shkel mbi ta e vi tek ti.

NUSJA — Ashtu, po frika s'na ikën lehtë ne grave.

*Të ulësh, se desh harrova. (Vete në juk, merr
një velenxë të kuqe flakë dhe ia shtron Çerçi-
zit.)*

ÇERÇIZI — U gëzove?

NUSJA — Pse të gënjej? Dilja në dritare e numëroja
yjet gjer në të gdhirë. Ka patur dhe një hënë
këtë javë... për të qëndisur.

ÇERÇIZI — E di, së ishim në mal e flinim jashtë.

NUSJA — Po rrobë sipër?

ÇERÇIZI — Me bërruc.

NUSJA — Shtohet fresku e të mardhnin llërët. Vjeh-
rrës dhe kunatës i thoshja e kënaqesha me
gjumë, kur më pyesnin për sytë.

ÇERÇIZI — Të rrish e qetë e herë tjetër mos rri në
penxhere.

NUSJA — Ashtu them dhe unë ditën, por natën s'më
rrihet në rroba. Tani do lahesh, do hash bukë?

ÇERÇIZI — Për bukë do pres Mihalin. Pa për të larë,
eja më qëro drizat e gurët që kam në trup.

NUSJA — Vij unë.

ÇERÇIZI — Shih mos ka mbetur ndonjë plumb në
rroba a në flokë.

NUSJA — Mos thuaj ashtu.

ÇERÇIZI — Atë që është them. *(Ajo i heq nga rrobat
gjembat ose gurët që ka marrë rrugës.)*

NUSJA — Ke erën e malit e të baltës në trup e në
rroba. Ruaju, Çerçiz.

ÇERÇIZI — Mësuar jam, s'më gjen gjë.

NUSJA — Të gjen, Çerçiz, të gjen. *(I qëron rrobat e
gjoksit. Ndalet në kraharor.)* Kraharori të rreh
fort, mos je me katër zemra, siç thonë për ty?

ÇERÇIZI — Me katër jam. *(E ngre në duar me fuqi
burri dhe e ve në minder në një çarçaf të bar-
dhë borë.)*

NUSJA — Unë kam vetëm një zemër. Ç'të të bëj
unë ty?

ÇERÇIZI — Ti të më bësh djem përdita.

NUSJA — Plot do të të bëj, një mëhallë, që të mos

... i sosë dot turku. E të jenë të gjithë të dukur
e trima si babai. (Zhurme në rrugë. Ka ardhur
patrulla turke. Trokitje të rënda tek dera e
shtëpisë. Pela në bahçe hingëllin e këputet.)

PATRULLA — Hapeni, hapeni! Hapni derën!

NËNA — (Nga brenda patit.) S'jua kam borxh, pse ta
hap?

NUSJA — Mëma!

(Çerçizi ka kërcyer përtpjetë e turfullon nga
inati.)

PATRULLA — Hape, se do ta shqyejmë!

NËNA — Ju thashë një herë, s'kam pse jua hap, s'jua
kam borxh.

PATRULLA — Duam djalin, ku e ke djalin?

NËNA — Gjejini ju.

PATRULLA — Do ta gjejmë e do ta therrim atë komit.

NËNA — Më bini dhe mua një filxhan gjak.

PATRULLA — A, shtëpi e pabesë. (Trokitje të rënda
në portë.)

ÇERÇIZI — (I nxehur.) Ik, o turk, mos më bëj xhind!
(Hidhet në dritaren që rri hapur për çdo rast.
Pela poshtë e ndien e hingëllin. Ai bëhet gati
të hidhet.)

NUSJA — (I vete pranë.) Na, na, Çerçiz, prit. Turku
mund të ketë zënë shtëpinë rreth e rreth e s'ke
nga shkon. Apo s'hingëllin sa s'këputet dhe
pela.

ÇERÇIZI — S'më kap njeri me të.

NUSJA — Ule gjakun.

ÇERÇIZI — Kur të derdhet do më ulet ky gjak me
turkun, po hajde të dal si njeri.

NUSJA — Prit pak. (Vete në dollap të rrobave të saj
dhe nxjerr shqiponja e një flamur të qëndisur.)

Merri, se të ruajnë! (*Çerçizi i merr; flamurin e fut në gjoks.*)

ÇERÇIZI — Të faleminderit, moj nuse. Tani mos u bëj merak, se më mbrojnë këto. (*Tregon shqiponjat dhe flamurin.*)

NUSJA — Çerçiz, të shoh një dritë të keqe në sy, mës bësh ndonjë hata.

ÇERÇIZI — Jo.

NUSJA — Të njoh në sy unë.

ÇERÇIZI — Dhe në befsha, mbi turq do ta bëj. (*Çerçizi ikën.*)

[Faint, illegible text, likely bleed-through from the reverse side of the page.]

KËNGË EPIKE

E hënë, pazar i madh,
Çerçizi e kish bërë fjalë,
Çerçizi e kish bërë fjalë,
djema, do vrini bimbashnë,
djema, do vrini bimbashnë,
t'ia numëroni në ballë.

S K E N A IV

Pazari origjinal i Gjirokastrës i fillimit të shekullit. Kanë zënë vend shitësit me gjithë plaçkë. Gjallëri e ditës së hënë, pazarit më të madh.

SHITËSI I DRITHIT — Grurë, grurë! Grurë për bukëvale!

SHITËSI II — Misër, misër! Bukë e fukarasë! Hajde misër, misër!

SHITËSI I FARËRAVE — Farë pjepri, një grosh filxhani i kafesë! Farë pjepri!

SHITËSI I ZILEVE — Zile e çokane të mira! Hajde! Zile e çokane! Këmborë nga Janina!

SHITËSI I FARËRAVE — Farë majdanozi! Një grosh qelqi i rakisë. Këtu, këtu!

SHITËSI I DRUVE — Dru të mira, dru të buta! Më i mirë zjarri se gjella. Dru të vjetra me zemër të kuqe!

SHITËSI I QIRINJVE — Llambadha, llambadha të mira! Qirinj, qirinj! Thimjamëra! Urdhëro e mermi! Llambadha!

SHITËSI I UJIT — Ujë nga krojet e Meçites! Ujë Bli-

ri, pus i ftohtë. Ujë pusi, eja, eja! Një qelq ujë,
një qelq rrurë!

SHITËSI I RAKISË — Raki rrushi, dy herë e zier. Ra-
ki e mirë. Të bie në qejf, po mendjen ta ruan.
Raki rrushi! Raki rrushi!

SHITËSI I MISHIT — Mish i vogël, ngrënë majën e
barit.

SHITËSI I BULMETIT — Qumësht me erë trënde-
linë. Kos i leshtë, ta presësh me thikë. Djath
i mirë!

SHITËSI I FARËRAVE — Farë bostani. Nga të gjitha
llojet.

SHITËSI I SHARQEVE — Sharqe të bardhë të më-
dhenj! S'i shpon era, s'i shpon plumbi. Sharqe
që të mbajnë gjallë.

(Zëra që dëgjohej.)

— Eja!

— Mbaroi, mbaroi!

— Û ngre plaçka. Kush ka të blejë, të blejë!

— Pa pishmanllëk. Mall i mirë!

(Hyn tellalli. Qetësi.)

TELLALLI — Dëgjoni, o popull! Del në axhitikëtë ka-
ndari i pazarit të Gjirokastrës. Janë paraqitur
tre veta. Vlefta e tanishme shtatëdhjetë lira. Po
ka myshterinj, të paraqiten për të prerë pazar.
Dëgjoni, o popull! Del në axhitikatë... (Tellalli
del. Rifillon zallahi e tregut. Vijnë e zënë vend
Godoja e Sirati që presin të vrasin bimbashin.)

SIRATI — Do na vonojë, jeziti.

GODOJA — Rri, dita jonë është.

SIRATI — Nuk më pritet.

GODOJA — Duro. Frika e qeverisë na ka dalë, gjersa
vimë e rrimë sheshit.

SIRATI — S'më mban vendi sa ta mbaroj.

GODOJA — Do kalojë. Ditë pazari, nuk sheh.

SIRATI — Ç'të bëj?

GODOJA — Kujto Çerçizin dhe shokët.

SIRATI — Dhe ata do jenë mërzitur duke ruajtur.

GODOJA — Nuk mërziten jo, ti je i paduruar.

SIRATI — Le që ata janë me Çerçizin. (*Pas pak.*) Nuk më pëlqen që do të ndahet çeta.

GODOJA — Jemi shtuar, për asgjë tjetër.

SIRATI — U shtofshim e u bëfshim një mijë, po nuk dua të iki nga komandë e Çerçizit.

GODOJA — Edhe Axhemi është trim e mëmëdhetar. Çerçizi nuk e çmon më kot.

SIRATI — Po ndryshe kapedani i parë. Ti me kë do rrih?

GODOJA — Me cilin të bëhet puna, si ta dojë e mirë e të gjithëve.

SIRATI — Unë dua me Çerçizin.

GODOJA — (*Që i sheh shqetësimin.*) Ç'ke?

SIRATI — S'më mban vendi.

GODOJA — Qetoje veten!

SIRATI — Po sikur të vonojë?

GODOJA — Aq më të madhe do ta marrë plagën.

(*Në anën tjetër dy vrasësit e paguar nga prefekti.*)

VRASËSI I — Po na doli para, do shtiesh ti.

VRASËSI II — Kush ta ketë për mbarë.

VRASËSI I — Ti je mësuar me gjakun.

VRASËSI II — Ti jo?

VRASËSI I — Kam frikë mos më zërë gjaku.

VRASËSI II — Nuk të zë, jo.

VRASËSI I — Po sikur?

VRASËSI II — Do të të hedh unë në krah.

VRASËSI I — Je i fortë.

VRASËSI II — Herë e parë është e rëndë, mësohesh pastaj.

VRASËSI I — (*Ligështohet e mendohet.*) Bërr...

VRASËSI II — Mos u ligështo si grua...

VRASËSI I — E ke pjekur ndonjëherë Çerçiz Topullin përballë?

VRASËSI II — Jo.

VRASËSI I — Ta shohësh e llafosemi.

VRASËSI II — Bir nëne është dhe ai.

VRASËSI I — Thonë se ikën si era e s'e zë plumbi.

VRASËSI II — Gjepura! Ti e ke parë?

VRASËSI I — Një herë kur doli gjokszbërthyer në pazar. Kur i zunë shokun nga Mashkullora.

VRASËSI II — Ç'bëri?

VRASËSI I — Sa u dha lajmi që zbriti nga Dunavati, pazari u zbraz.

VRASËSI II — Gjepura prapë.

VRASËSI I — E di ç'them?

VRASËSI II — Hë.

VRASËSI I — Të vëmë kokën e një tjetri në torbë e t'ia dërgojmë mytesarifit. (*Hyn tellallë për njoftim tjetër. Shitësit e blerësit mbajnë vesh.*)

TELLALLI — Dëgjoni, o popull! Dëgjoni, o popull këto habere! Gazeta nga Janina! Sulltani ka thënë: shqiptarët i kam xhan. Shqipërinë do ta bëj manare. Dëgjoni, o popull: shqiptarët... xhan, Shqipërinë... manare.

(*Hyn prefekti i Gjirokastrës, i vënë në mes nga mitropoliti grek Papallambraqis dhe myftiu i fesë myslimane. Ata kalojnë tërë pazarin!*)

PREFEKTI — Veliu i Janinës pas kaq kohe më ka bërë prapë dhurata.

MITROPOLITI — Ç'ka dërguar valiu i madh këtë herë?

PREFEKTI — Dy zagarë.

MITROPOLITI — Urdhëro, zoti mytesarif?!

PREFEKTI — Dy zagarë gjahu.

MITROPOLITI — Shënjat janë për mirë. Pas dhurave nuk do përë ndonjë mendim i valiut të madh.

PREFEKTI — Dhuratat e tij janë gjithmonë me kuptim.

MITROPOLITI — Në këtë rast kuptimi i tyre është gjahu, dëfrimi, mytesarif.

PREFEKTI — Nuk besoj se në një kohë të tillë valiut i shtyn nëpunësit e Portës në qejfe.

MITROPOLITI — Ç'të jetë kuptimi i zagarëve atëherë, mytesarif i lartë?

PREFEKTI — Që unë të rend pas prishësve të vendit.

MITROPOLITI — Çerçiz Topullit?

PREFEKTI — Shpëtova nga arabët e Jemenit. Do shpëtoj vallë nga shqiptarët?

(Tellalli. Ai njofton shpalljen e prefekturës që kërkon me para kokën e Çerçiz Topullit.)

TELLALLI — Dëgjoni, o popull! Thirrje e prefekturës së Gjirokastrës: Kur Shqipëria do të rrijë nën hijen e dōvletit dhe shqiptarët i thërrasin sultanit baba, bashkomiti Çerçiz Topulli me të tjerë është kryengritur. Rruga e tij është rebelle. Prefektura bën thirrje: kush e mban fshehur ta japë, kush e ndesh ballë ta godasë. Prefektura ka vënë për kokën e Çerçiz Topullit

1500 lira turke. Dëgjoni, o popull!

NJË SHITËS — Dëgjoni ç'thotë prefektura!

BLERËS — Hyqymeti i bën llogaritë gabim me Çerçizin.

(Zëra nga populli.)

— Oi, të japë kokën, thonë.

- Çerçiz Topulli të nxirret në pazar?
 — Hiç mos u mërzit, e Çerçizit do të bëhet.
 — Ajo kokë nuk pritet nga shpatë e Turqisë.
 — Çerçizi është nderi i Shqipërisë. (*Hym plaku Guro.*)

NJË BLERËS — Plaku Guro! (*Mblidhen njerëz rreth tij.*)
 (*Zëra.*)

- Një këngë, zoti Guro, ngre një këngë.
 — Mos, ka merak për Çerçizin!
 — Asnjë merak mos ketë. Çerçizin-s'e gjem e liga.

PLAKU GURO — Ky valiu qan me lot,
 O qan me lot,
 kam Çerçiznë e s'e zë dot,
 O s'e zë dot,
 kam Çerçiznë e më prish punë,
 se më ngre vendin në këmbë.
 (*Zëra.*)

- Dëgjoni, dëgjoni!
 — Zoti Guro ngriti këngë.
 — I lumtë goja!

— Po shkopi ç'thotë, zoti Guro?

PLAKU — Vështro! (*Ngre lart bastunin. Koka e tij është një këmbanë.*)

NJË BLERËS — Ç'është, zoti Guro?

PLAKU GURO — Foli, foli, se të jep xhevapovetë.
 (*Ai e tund. Bie gjuhëza*) (*Zëra.*)

— Këmbanë, zoti Guro.

— Çerçiz Topulli ngre në këmbë njerëz dhe mbledh rreth popull.

- Ashtu, zoti Guro, ashtu!
 (*Plaku Guro bën teja Prapaci venë njerëz. Në pazarin ku është Godoja dhe Sirati afrohet dja-*

li i Çarçan Mazes, Shahini, 16 vjeç, i ri dhe i
bukur, me zile në dorë.)

SHAHINI — Ju pëlqejnë këto zile?

GODOJA — Çfarë thua?

SHAHINI — Zilet, them, ju pëlqejnë?

SIRATI — (I merr në dorë.) Të mira janë.

GODOJA — Këndofshin në qafë të deleve.

SHAHINI — I dini malet, më ngjan,

GODOJA — Kujë di ti?

SHAHINI — Më dukeni si të njohur.

GODOJA — Ore!

SHAHINI — Si thoni ju, bie Çerçizi në dorë të turkut?

GODOJA — Kush je ti? Ç'bën?

SHAHINI — Me ju jam, po këtë më thoni.

GODOJA — Ik tani, shko në dhen.

SHAHINI — Ia kam lënë Çarçan Mazes sot.

SIRATI — (Që i jep të njohur.) Kujt, kujt?

GODOJA — (E zë nga krahu për t'i thënë: mos.) Ke
rrugë për të bërë nisu!

SHAHINI — Nuk më ktheve përgjigje: bie Çerçizi
në dorë të turkut?

GODOJA — Kurrë!

SHAHINI — Atë them dhe unë. Tani, shëndoshë!
(Ikën nga ata i gëzuar.)

SIRATI — Do ta tregojmë ne si bie Çerçizi në dorë
të turkut.

GODOJA — Ul gjakun, Sirat!

(Hyn tellalli.)

TELLALLI — Dëgjo, o popull: bashkomiti u dha,
mbliidhu tek xhamia. Do vijë të ulë kokën
Çerçiz Topulli. Dëgjo, o popull: bashkomiti u
dha.

(Del. Reagim tek njerëzit.)

— Ç'është kjo?

- Hyqymeti gënjen.
- Çerçiz Topulli të bjerë?!
- E njeh Çerçiz Topullin ti?
- Gjë që s'bëhet.
- Do ta shohin si bie Çerçizi, prit.
- Hapin fjalë të tremben njerëzit.
- Prefektura është mësuar me të rrema.
- Njerëz të tij dje erdhën e hoqën armë.
- I pe vetë?
- Me këta sy.
- Armëtari i parë i pazarit i zbukuroi revolen.
- Bimbashi ka bërë be.
- As Çerçizi s'i ndahet.
- Dhe Çerçizi di e të vret në mes të ditës.
- Hajde, hajde, Çerçiz Topulli!

(Alem Libohova kalon me një lloj frike e alarmi. Është me vesh ngritur. Bën të dalë. Përballë ndeshet me plakun Guro.)

PLAKU GURO — *(Pasi i ka dhënë shenjë Godos dhe Siratit, i drejtohet masës:)*

Del një bej, del një aga
thotë se Çerçizi ra.
Gënje, prefekturë, gënje
po Çerçizi është e s'vdes.

(Reagim. Njerëzit i drejtohen plakut Guro, po ai s'flet më e del. Hyjnë me madhështi kryetari Kapo dhe anëtarë të komitetit kombëtar të Gjirokastrës; në ecje kanë siguri e besim. Qëndrojnë para shokëve të Çerçizit që do të vrasin bimbashin.)

KAPO — Si ndiheni?
GODOJA — Mirë.

SIRATI — Gati jemi.

KAPO — Dhe pak e bimbashi niset t'i bëjë të fala
papa Fotit.

GODOJA — Po vjen?

KAPO — Tani!

SIRATI — Do të ta shkul zemrën e zezë, bimbash
halldup!

KAPO — Çerçizin e keni në krahë.

SIRATI — Hiç merak të mos keni. E mbarojmë ne.

KAPO — Me ju jemi të gjithë.

*(Përfaqësuesit e komitetit kombëtar dalin.
Pazari gjallërohet si asnjëherë. Diku, shitës e
blerës, provokojnë një grindje.)*

— Hajde, iku pazari, iku!

— U ngre dielli, bëmë mushkat për udhë.

— Saçma, saçma!

— Melhem për plagë.

*(Mespërmes pazarit kalon një grua veshur
me të zeza: Xhiko Braja.)*

— U ngrenë plakat e jetës. Një gjë e madhe
do ndodhë.

— Xhikua do shohë Çerçizin. I ka dhënë gj
kur ka qenë i vogël.

— Grua trime! *(Plaka ka dalë nga skena. Në
një qoshe ka plasur sherri.)*

— Pse, gënjeshtar jam unë?

— Ca më keq.

— Jo, ti....

— Ç'më di mua, rremash si veten. Unë...

— Hesht!

— Saçma, saçma!

— Melhem për plagë.

— Hilera, hilera. S'bëhet pazari me hilera.

— Llogari e prishur, pazar i prishur.

— Më hëngri mallin!

— Melhem për plagë, melhem!

(Hyn bimbashi me kapadaillëk i shoqëruar nga një suitë e madhe.)

BIMBASHI — U bastisën shtëpitë?

XHANDARI — U bastisën, bimbash.

BIMBASHI — Faresi i Çerçiz Topullit u nis për në Janinë?

NJË NGA SUITA — Arabatë do bien pluhur nga kryevendi i vilajetit.

BIMBASHI — Ashtu po!

NJË NGA SUITA — Do vijë koha kur këtë milet do ta trembësh edhe vetëm me emrin, bimbash i lartë.

BIMBASHI — Unë do ta quaj punën time të plotë kur edhe po të jenë grumbull si sot, këta mos e mendojnë rebelimin.

NJË NGA SUITA — *(Duke i bërë qejfin.)* Kësaj po ia harrini, bimbash.

BIMBASHI — Tani të merren masa të qetohet kjo rrëmujë.

XHANDARI — Menjëherë, bimbash i lartë! *(Bëjnë të shkojnë. U presin rrugën Godoja dhe Sirati.)*

GODOJA — Bimbash! Kemi ardhur nga larg e të kërkojmë.

BIMBASHI — Kush jeni ju?

GODOJA — Çerçiz Topulli të bën të fala. *(Shtie.)*

SIRATI — T'i kam dhe unë dy fjalë. Për ata që ke mbyllur në burg të Janinës.

GODOJA — Për djemtë e rinj që ke veshur nizamë, për shkollat që ke mbyllur dhe për gjithë ç'hoqi Gjirokastra, populli të paguan me plumb!

SIRATI — Prite, bimbash i zi! *(Qëllojnë të dy.)*

XHANDARI — Vrasësit, vrasësit! *(Rrëmujë.)*

(Zëra.)

— Bimbashin, vranë bimbashin!

— Çerçiz Topulli ka dërguar shokë!

SIRATI — U vra halldupi! U vra, halldupi! Proftë
Shqipëria e lirë!

GODOJA — Sirat, Sirat! (*Dëgjohen pushkë nga larg.*)

SIRATI — Shtie Çerçizi me shokë.

GODOJA — Shpejt se do vijnë xhandarë dhe asqerë.

(*Shtie përperjetë. Dëgjohe thyerje e xhamave
të mëdha të hyqymetit.*)

SIRATI — Po i bie hyqymetit?

GODOJA — Me sa më ha krahu.

SIRATI — Turqi, ma more të keqen! Edhe bimbashin ta vramë, edhe hyqymetin ta goditëm.

(*Hyjnë xhandarmëria. Ata dalin. Rrëmuje.
Vijnë personazhe që kanë hyrë e kanë dalë
në këtë skenë. Populli gëzon.*)

KËNGË EPIKE

Doli shkurti, hyri marsi,
në Mashkullorë te rrapi,
te rrapi në Mashkullorë,
foli Çerçizi me gojë,
foli Çerçizi me gojë,
leri djemtë e mi të shkojnë,
leri djemtë e mi të shkojnë,
se ju kuq, ju bëj me bojë.

S K E N A VI

*Në Mashkullorë. Fund nate. Hauri që u bë ka-
la. Godoja bën roje. Pas pak vjen Majkoja.*

MAJKOJA — Godo!

GODOJA — *(Kthehet me vrull.)* Kush foli? A, ti Maj-
ko je?

MAJKOJA — Ç'orë të jetë?

GODOJA — Fundi i natës, besoj.

MAJKOJA — Yje ka akoma.

GODOJA — Sonte sikur i shtiva me gishta. Ti, pse u
ngrite?

MAJKOJA — Më doli gjumi. Vendi dëgjon behar.

GODOJA — Mëngjesi bën fresk akoma.

MAJKOJA — Nuk mërdhi. *(Bën një hap. Ndihet i
gëzuar.)*

GODOJA — Syri të flet gëzim.

MAJKOJA — Hyri dhe marsi. Tani që hapi koha të
bën të ngrihesh me natë e t'i hysh tokës me
duar, t'i hysh.

GODOJA — Të ka marrë malli?!

MAJKOJA — Të punosh gjithë mëngjesin. Të dalë dhe
një diell i bukur që ti ngjajë Çerçizit, pastaj.

- GODOJA** — Majko, na kujtove shtëpitë.
- MAJKOJA** — U liga sonte, nuk e di ç'kam.
- GODOJA** — Jo, jo!
- MAJKOJA** — Ti, Godo, je trim.
- GODOJA** — Si të gjithë.
- MAJKOJA** — Ti u bëre dhe me këngë: Godo labi gu-
nëbardhë/Gjirokastër bëre hatanë. Për bim-
bashin.
- GODOJA** — Po në krahë ju kishim ju.
- MAJKOJA** — Unë do të di të jem aq trim?
- GODOJA** — Edhe më.
- MAJKOJA** — Të luftës jemi, fundja.
- GODOJA** — Ashtu! (*Hyn Sirati me një fletore në dorë. Është ngritur që pagdhirë për të mësuar një këngë. Në fillim nuk i sheh.*)
- MAJKOJA** — Po ky?! (*Sirati i ndien dhe turpërohet. S'di ku të futë fletoren.*)
- MAJKOJA** — Sirat, si u gdhive?
- GODOJA** — (*Me shaka.*) Ai s'ka mbyllur sy mbrëmë.
- SIRATI** — Më lini, o vëllezër. S'mbaj që s'mbaj mend gjë. A, këtë të mos kishte çeta.
- GODOJA** — Po ku të lë Mihali, pa?
- SIRATI** — Le Mihali, po urdhëri i Çerçizit: të më-
sosh shkrim, se ndryshe s'i duhesh çetës. A,
pushkë, të puthsha grykën.
- MAJKOJA** — Eja të të ndihmoj. (*I vete afër.*) Ku je?
- SIRATI** — Ja, këtu!
- MAJKOJA** — (*I tregon një fletore. Majkoja lexon.*)
- Vdekja kurrë s'më tremb mua
si çdo tjetër njeri
se vdekjen e kemi hua
po lum kush vdes për liri!**

E ka shkruar Mihali. Këtë këngë ia ka ngritur Bajos.

SIRATI — Bajo Topullit, the?! Po ç'bëj unë?

MAJKOJA — Eja e mësojmë duke kënduar. (*Nisin këndojnë vargje të dy; lehtë. Afrohet dhe Godoja. Vjen Çerçizi dhe Mihali.*)

MAJKOJA — (*I sheh.*) Çerçizi dhe Mihali! (*Të tre rrinë me nderim.*)

ÇERÇIZI — E, djema?!

MAJKOJA — Mirë, kapedan.

GODOJA — Mirë, Mihal.

SIRATI — Mirë.

MIHALI — Si kaloi nata, Godo?

GODOJA — Nuk pati gjë.

ÇERÇIZI — (*Siratit e Majkos.*) Ju, djema, ç'jeni ngritur kaq shpejt?!

MAJKOJA — Na doli gjumi, kapedan.

GODOJA — Majkoja erdhi e na kujtoi shtëpitë dhe arat, Çerçiz. Kurse Sirati, Mihal... (*Zë qesh. Sirati i bën me shenjë.*)

MIHALI — Vuri shenjë që pagdhirë?

GODOJA — Jo, zuri të mësojë. (*Mihali qesh.*)

ÇERÇIZI — Majko, të ka marrë malli për tokën? E ke dhe me hak.

MAJKOJA — Jo, kapedan, sonte nuk e di ç'pata.

ÇERÇIZI — S'ka gjë, s'ka gjë. Malli i mirë nuk e dobëson burrin e luftës.

MAJKOJA — Them mos nuk është koha, kapedan.

MIHALI — Është edhe koha, Majko. Kur bëhet një vend, është koha për të gjitha. Shqipërinë do ta kemi me gjithë nuret.

MAJKOJA — Kaq vjet maleve, më ngjan se kam lërrë e rroj në fole të shqipeve.

ÇERÇIZI — (I përkëdhël kokën me dashuri.) Eh, mëre Majko!

MAJKOJA — (Duke i treguar gunën e vet.) Do gunën, kapedan?

ÇERÇIZI — Jepja Mihalit. Dua të më mbushet gjoksi me erë.

MAJKOJA — E do, Mihal? (Ia hedh krahëve.)

ÇERÇIZI — Ke të drejtë ti, Majko, se shkuam vite me armë. E s'u dhamë. Ç'bëmë? Ja, po ngremë Shqipërinë. Pushka ka punë akoma, po mëmëdheu mori rrugën e mbarë.

MIHALI — Rrugën e lirisë, më të bukurën.

SIRATI — Ju na dhatë krahë, Çerçiz e Mihal.

MIHALI — Krahët na i dhanë njerëzit e vatanit.

MAJKOJA — Po bie mëngjesi, kapedan. Ikin yjet e qielli hapet.

ÇERÇIZI — Ju rrimi. Unë dhe Mihal do bëjmë deri tej. (Bëjnë të dalin. Qetësi. Muzikë. Godoja sheh me shqetësim larg.)

SIRATI — Ç'ke, Godo?

GODOJA — Shih përtej, mjegull është ajo që lëviz apo njerëz? (Çerçizi vjen me vrull.)

ÇERÇIZI — Ç'vështroni ashtu larg?

GODOJA — Çerçiz, shquaj përtej.

ÇERÇIZI — O burrani, djema, se na rrethoi ushtria. (Zallahi e ushtrisë që lëviz.)

MIHALI — Çerçiz! Kjo dësmë bëhet për ne.

ÇERÇIZI — Alem Libohova na ka kallzuar te hyqmeti.

GODOJA — Le të vijmë, kapedan.

ÇERÇIZI — Lufta s'më tremb, djema, se burrëria e trimëria s'na mungon. Po them për tradhtinë. Kështu e kanë prerë në besë Shqipërinë.

SIRATI — Ç'na thua të bëjmë, kapedan?

ÇERÇIZI — Unë them se vdekja është më e mirë se gjallja me çnderim. Zini një rrënjë guri dhe të luftojmë si të qëmotshmit. Nata që e turkut, jona është dita.

TË GJITHË — O liri, o vdekje, kapedan!
(Zënë vendet për luftë. Ngrihet një diell i madh. Thellë dëgjohej një zë.)

— O Çerçiz Topulli!

MIHALI — Dëgjo! (Mbajnë vesh.) Kush të jetë?

ÇERÇIZI — Ja tek vijnë! (Hyjnë Shahini, dhe Begë Leskoja. Edhe Begë Leskoja tani është me fustanellë, i tëri i bardhë. Vijnë me krahët hedhur njëri-tjetrit në një gjest burrash.)

SHAHINI DHE BEGA — Armët të nderura, burra!

ÇERÇIZI — Nderuar qofshi! Erdhe, Begë Leskoja?

BEGA — Erdha të matem me turq.

ÇERÇIZI — Ke boll. (Tregon ushtrinë që afrohet.)

BEGA — E di.

SHAHINI — Çerçiz, ti nuk më njeh, po jam Shahini, djali i Çarçan Mazes. Babai të bën të fala. Ty edhe shokëve.

ÇERÇIZI — I Çarçan Mazes, the? (I pushton të dy me krahë.) Ditë të rëndë zgjodhët për të ardhur.

SHAHINI — Këtë ditë pritëm.

BEGA — Tani e tutje jetën e kemi me ju.

MIHALI — E ka thënë Çarçani.

ÇERÇIZI — Ai që del komit, djema, betohet për liri. Kështu është zakoni i kanonizmës së malit. Po ju nuk ju vemë në be, se erdhët në ditë të vështirë, kur duhen shokët.

TË DY — Ja tek na keni.

ÇERÇIZI — Eja turqëri! (Zhurmë. Ushtria ka ardhur

afër. Fjalë të pashkoqitura mirë. Vjen një i dërguar i turqve.)

I DËRGUARI — Kapedan i komitëve, o komitë!

ÇERÇIZI — Zbrit e foli, Godo! (Godoja ulet.)

GODOJA — Urdhëro e fol.

I DËRGUARI — A na dëgjon kapedan Çerçiz Topulli?

GODOJA — Fol!

I DËRGUARI — Zoti mytesarif i Gjirokastrës ju fton të lini armët.

GODOJA — Armët kanë zot!

I DËRGUARI — Të njoftohet kapedan Çerçiz Topulli: zotëria e tij, mytesarif i Gjirokastrës, do të flasë me të sy më sy. Zotëria e tij kapedan Çerçiz Topulli është i ftuar.

GODOJA — Po ia them! (Hyn prefekti i Gjirokastrës, mitropoliti grek, komandanti i asqerëve dhe mjeku. Mbi ta, në shkëmb janë Çerçizi dhe Mihali në vijë të parë dhe pas Godoja, Sirati, Majkoja, Shahini dhe Begë Leskoja që turfu-llon herë pas here nga inati.)

ÇERÇIZI — (Rreptë.) Fol, mytesarif i Gjirokastrës!

PREFEKTI — I dëgjuari i kryekomit Çerçiz Topulli, ne mund të merremi vesh me të butë. Lufta është e rëndë dhe u ngre nervat burrave.

ÇERÇIZI — Plumbi e baruti për ta është.

PREFEKTI — Ajo i hedh edhe në dëshpërim. Ne presim t'i zbutet gjaku kryekomitit të dëgjuar.

ÇERÇIZI — I vetmi dëshpërimi im ka qenë Shqipëria. Sa për gjakun nuk ka për të na u zbutur kurrë.

PREFEKTI — Kur nuk zbutet, ai derdhet kot. (*I tregon ushtrinë.*) Brinja nxin nga asqerët.

ÇERÇIZI — Keni tjetër?

MITROPOLITI — (*Bën një hap dhe i thotë diçka prefektit.*) Nuk ka për t'u zbutur. Shih, ne me të mirë, ai me inat.

PREFEKTI — Çerçiz, Turqia të fal. Kthehu!

ÇERÇIZI — Unë s'kthehem. Turqia të vijë të më zërrë, mos më falë.

PREFEKTI — Hëm... ç'kërkon që ke dalë kundër?

ÇERÇIZI — Kërkojmë Shqipërinë.

PREFEKTI — (*Butë.*) Po ja, Shqipërinë e keni.

ÇERÇIZI — Shqipërinë e duam pa Turqinë.

PREFEKTI — Po kjo s'bëhet, trim, se perandoria është e madhe dhe prishet po të prishet bota.

MIHALI — Çerçizi është kombëtar dhe përpiqet për vatanë.

PREFEKTI — Me këto që thotë dhe bën, Çerçizi 'e prish e jo e bën vatanin. (*Çerçizit.*) Ti mund të marrësh poste të larta në hyqymet e të përpiqesh për Shqipërinë.

ÇERÇIZI — Nuk më pëlqen të jem memur.¹⁾

PREFEKTI — Prapë ne mund të bëhemi të një mendjeje.

ÇERÇIZI — Pritmën e Atdheut e lidhin dhe e zgjidhin përfaqësuesit e kombit. Unë vë në jetë dëshirën e tyre.

PREFEKTI — Grada s'do, para s'do, pozita në shtet s'do, atëherë ç'do ti, Çerçiz Topulli?

1) nëpunës (rrogëtar)

ÇERÇIZI — (*Me ironi.*) Dua t'ju luaj pak shiltetë e buta.

PREFEKTI — Ti del kundër Stambollit?

ÇERÇIZI — Unë jam ngritur kundër sulltanit.

PREFEKTI — Me këta pesë komitë?

ÇERÇIZI — Këta janë një kala.

PREFEKTI — Të tjerët urojnë të jenë nën hijen e padishahut, tjetër ju shqiptarët?!

ÇERÇIZI — Ne sa jetë të kemi për Shqipëri.

PREFEKTI — Ahere, këtu do t'i lini kockat, brenda darës sonë. Ju kemi rrethuar.

ÇERÇIZI — Ne nuk e njohim rrethimin. (*Ata bëjnë të dalin.*)

PREFEKTI — Komit arnaut!

KOMANDANTI I ASQERËVE — Trim, po i paditur.

MITROPOLITI — I mallkuar, i mallkuar!

ÇERÇIZI — Mjerë ju, dërgatë e sulltanit. (*Pas pak.*)

Hajde, djema! Gjithë këta nuk vlejné sa një fjalë e Mihalit e sa një plumb i Siratit. (*Bori e turqve.*)

TURQIT — Komita, dorëzohuni se jeni të rrethuar!

— Jepuni pa luftë!

— Për tek ju nuk do të lemë të kalojë as era.

— Faluni zotit tuaj, thoni ç'keni për të thënë.

— Ike, mbarove, Çerçiz Topulli!

MIHALI — (*Duke u ngritur fuqishëm.*) Çerçiz Topulli s'vdes sa kohë s'vdes Shqipëria!

(*Korale.*)

Leri djemtë e mi të shkojnë,
se ju kuq, ju bëj me bojë,
Çerçiz Topulli më thonë.

ÇERÇIZI — Bini, o djema, se me gjak bëhet Shqipëria. *(Të shtëna.)*

MIHALI — Kjo është fjala e Çerçizit!

GODOJA — Komandant i asqerëve m'i bëj të fala bimbashit!

SIRATI — Këtu maten burrat!

MAJKOJA — Komiti i lirisë nuk di ta ulë kokën.

ÇERÇIZI — Folët mirë, djema! Osman i zi, do m'Ë paguash vuajtjet e Gjirokastrës e gjithë ç'hoqi Shqipëria. Do ta mbush rrapin me të vrarë!
(Të shtëna.)

MIHALI — Çerçiz, folu djemve se do dehen e s'do dinë të ruhen.

ÇERÇIZI — Djema! Mbani istikamin e kujdes veten.

SIRATI — Të kemi kapedanin mirë.

ÇERÇIZI — Kapedani nuk e njeh vdekjen.

MAJKOJA — Atëherë, as ne nuk na kap plumbi i turkut!

ÇERÇIZI — Ruajuni, Shahin e Begë, mos u ngreni.

BEGA — Unë e di që Çerçizi e bën luftën më këmbë.

MIHALI — Çerçizi është rritur me luftën, ju jeni të rinj në moshë.

BEGA — Të ruhet Shahini, se mua s'më gjen gjë.

ÇERÇIZI — Godo, më ki kujdes djemtë.

GODOJA — Plumbin e tyre e marr unë, kapedan.

ÇERÇIZI — Dhe mos shtini kot, djema. Ruani fishekët.

SIRATI — Në s'na dalçin, edhe me gurë kapedan.

ÇERÇIZI — Bëni llogari: secili ka nga tridhjetë asqerë.

GODOJA — Të çmuar o të çmuar që na bën doverti.

BEGA — (Të gjithëve.) Erdhi ora të kap ndonjë turk nga mjekra. (*Sulet vetëtimë drejt tyre.*)

ÇERÇIZI — Prit, Begë, prit!

SHAHINI — U bë erë.

ÇERÇIZI — Do bëjë ndonjë gjëmë!

MIHALI — (*Çerçizit.*) Dëgjoji, u këndojnë armët në duar. Djalëri e Shqipërisë, djalëri.

ÇERÇIZI — Kjo pushkë që shtiu, është e Shahinit. E, mor Çarçan Maze. (*Vjen Godoja.*)

GODOJA — Çerçiz, Çerçiz!

ÇERÇIZI — Ç'është, Godo ç'ke?

GODOJA — Çerçiz, na vranë Shahinin.

ÇERÇIZI — Shahinin? Ç'më thua, Godo?!

GODOJA — Ja tek e bien mbytur në gjak Majkoja me Siratin. (*Majkoja dhe Sirati bien Shahinin e plagosur rëndë. Godoja u hap rrugën.*)

SIRATI — Kërkon Çerçizin të japë xhanë.

ÇERÇIZI — Shahin, Shahin!

SHAHINI — Të dëgjoj kapedan.

ÇERÇIZI — More plagë?

SHAHINI — Në gjoks, kapedan.

ÇERÇIZI — Bëj kurajo, duroi dhëmbjet.

SHAHINI — Do t'i duroj, se për të marrë plagë erdha.

ÇERÇIZI — Luftove si trim.

SHAHINI — Tani s'kam gjë. Dhëmbjet m'i more ti, kapedan.

ÇERÇIZI — Çarçani diti të rriti e ti dite e luftove.

SHAHINI — Për vatanë.

ÇERÇIZI — Shqipëria u ngre.

SHAHINI — Atë dua dhe unë.

ÇERÇIZI — Kështu, Shahin, kështu.

SHAHINI — Çerçiz, po vdiqa, mos më lerë në dorë të turqve, po më merrni kryet.

ÇERÇIZI — Nuk vdesin kollaj bijtë e Çarçan Mazës.
(*Shahini jep shpirt.*)

MIHALI — Çerçiz, ai po jep shpirt. Na iku djali nga duart.

ÇERÇIZI — Kaq e pat.

MIHALI — Plumbi e ka marrë tejpartej dhe vdiq i bukur si ylli. (*Çerçizi i pari dhe pas tij të tjerët heqin festet dhe nderojnë. Mbuluar me bërruc, e ngre Çerçizi dhe Mihali.*)

MAJKOJA — (*Siratit.*) Shiko, Çerçizi di të qajë. (*Zhurme që rritet; vijnë në ndihmë të çetës. Hyn përnjëherësh Begë Leskoja; ka në dorë një çallmë turku. Duke kaluar mespërmes tyre, fustanella i ka marrë flakë dhe nga lëvizjet plot vrull të djalit, ajo bën figura të shumta me zjarrin.*)

BEGA — Çerçiz!

ÇERÇIZI — E, Begë, ja tek e zure dhe turkun nga mjekra. More hakë.

GODOJA — Shuaj fustanellën, Begë.

BEGA — Lemë të tremb turq.

ÇERÇIZI — Na duhesh, more Begë. (*Hyn Çarçani mbajtur e veshur si një burrë i asaj moshe. Në mëngë, në gjoks ose në qelëshe, ka të shkruar me pë të kuq L-në, germën që i ka mësuar dikur Mihali. Mihali e sheh dhe qeshet nga gëzimi.*)

MIHALI — Çerçiz, po vjen Çarçani. (*Çarçani ka hyrë.*)

ÇERÇIZI — Çarçan....

ÇARÇANI — (*Që e ka kuptuar vdekjen e djalit.*) Mos ma thuaj atë fjalë, Çerçiz. (*Përqafohen.*)

MIHALI — Çarçan! Zgjidh njërin nga ne.

ÇARÇANI — Çerçiz, të kam bërë djalë.

ÇERÇIZI — Dhe unë të kam bërë baba.

(Zëra turqish:)

— Komitë! Ç'bëni, pse s'qëlloni?

— S'do t'ju lëmë as për t'ju varrosur.

— Kështu do mbaroni të gjithë.

— Iku njëri, jua vramë.

ÇARÇANI — Mirë bëtë! (Çerçizi e Mihali e marrin midis tyre.)

ÇARÇANI — Rrugët janë plot, Çerçiz. Turku do bjerë.

GODOJA — U ngritën stanarët.¹⁾ U shkul Mashkullorë e tërë.

(Skena përflaket. Hapa. Zëra burrërorë.)

MAJKOJA — Po vijnë, po vijnë!

MIHALI — Kjo është çeta e Mashkullorës. Pas e ndjek çeta e Xhikut. Tej janë të Lunxhit. Komiteti i Gjirokastrës na vjen në ndihmë. (Vjen plaku Guro.)

PLAKU GURO — Ç'i ndrinë armët, ç'i ndrinë, këta djema vetëtimë.

O Çerçiz, ç'e bëre mirë,
na nderove Shqipërinë.

ÇERÇIZI — Të lumshin këmbët e të lumtë goja, plaku Guro!

PLAKU GURO — Të lumtë ty e djemve, Çerçiz!

MIHALI — Vijnë akoma. Bëju vend për luftë të gjithëve, kapedan Çerçizi.

1) njerëzit e staneve.

ÇERÇIZI — Le të vijnë! (*Skena është mbushur.*)

PLAKU GURO — Çerçiz, mblodhe Shqipërinë.

ÇERÇIZI — Ne sido që të na ndodhë,
dimë bëjmë rrugë e shkojmë.

Hasmin e kuqim me bojë,
Shqipërinë s'e turpërojmë.

*(Çerçizi nxjerr flamurin nga gjoksi dhe e tund.
Flamuri bën rrathë të bukur që ngjajnë me valle ose
vetëtima. Korale e fuqishme. Triumfale.)*

FUND

Tirazhi 1000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1979